



Republike e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn / Municipality Vushtrri
Kryetari – Precednik – Mayor



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, nenin 1 dhe 9 të Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Vushtrrisë nr. prot. 156/16, dt. 28.07.2016, si dhe pas konsultave publike me qytetarë dhe konfirmimit të gatishmërisë së tyre për lartësinë e pagesës në emër të participimit për kyçje në rrjetin e ujësjellësit në vendbanimet e tyre, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M



1. Me këtë vendim, caktohet lartësia e pagesës për ekonomi familjare dhe komunitetin e biznesit në fshatrat e Komunës së Vushtrrisë, në emër të participimit me mjete financiare për projektin “Zgjerimi i Rrjetit të Ujësjellësit”, si vijon:
 - 1.1 Për ekonomi familjare – 80.00 €
 - 1.2 Për biznese – 150 €
2. Kategoritë në vijim lirohen nga participimi:
 - 1.1 Familjet që përfitoj asistencë sociale;
 - 1.2 Familjet e Dëshmorëve;
 - 1.3 Familjet e Martirëve;
 - 1.4 Invalidët e Luftës së UÇK-së;
 - 1.5 Veteranët e UÇK-së.
3. Mjetet financiare për qëllimin e cekur në pikën 1, duhet të grumbullohen në secilin fshat nga këshilli i fshatit dhe derdhen në llogarinë bankare të Komunës së Vushtrrisë.



Republike e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn / Municipality Vushtrri
Kryetari – Precednik – Mayor



4. Komuna e Vushtrrisë do të siguroj pjesën tjetër të mjeteve financiare në emër të participimit nga buxheti i komunës, fondi për bashkëfinancim, me qëllim të implementimit të këtij projekti.
5. Komuna e Vushtrrisë do të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me këshillat e fshatrave dhe përfaqësuesit e autorizuar të bizneseve nëpër fshatra për shfrytëzim - përdorim të mjeteve financiare për kyçje në rrjetin primar të ujësjellësit, në territorin e komunës për furnizim me ujë të pijes.
6. Vendim publikohet në faqen zyrtare të komunës.
7. Për zbatimin e këtij vendim do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shërbime Publike dhe drejtoritë tjera sipas nevojës, Zyra për Informim Publik, Zyra e Kryetarit të Komunës Këshillat e Fshatrave dhe përfaqësuesit e bizneseve në fshatra në të cilat bëhet kyçja në rrjetin e ujësjellësit.
8. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Xhafer TAHIRI

Kryetari i Komunës së Vushtrrisë

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Drejtorisë për Shërbime Publike,
- Zyrës për Informim Publik
- Kryetarëve të Këshillave të Fshatrave
- Arkivit të Sekretarisë.